

Detyrime të vecanta

Përditësimi i fundit 11 Mars 2025

Detyrimi për të ofruar kushte pune të shëndetshme dhe të sigurta

Punëdhënësi është i detyrur të marrë masat e përcaktuara në Kodin e Punës dhe legjislacionin rregullues për kushte pune të sigurta dhe shëndetshme, duke mbrojtur punonjësin nga cdo element që është i dëmshëm për jetën dhe shëndetin e punëmarrësit (Kreu VIII i KP).

Baza ligjore: Kodi i Punës

Masat për të koordinuar veprimet e punëdhënësit për të siguruar sigurinë dhe shëndetin në punë

Në rastin kur punëmarrësit e shumë ndërmarrjeve përdorin të njëjtin vend pune, punëdhënësit duhet të bashkëpunojnë për zbatimin e dispozitave për sigurinë, higjienën dhe shëndetin, duke pasur parasysh natyrën e veprimtarisë së punës. Ata duhet të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre, me qëllim mbrojtjen dhe parandalimin e rreziqeve profesionale, duke caktuar një koordinator për sigurinë dhe shëndetin, si dhe të shkëmbejnë reciprokisht informacione për këto rreziqe, për të cilat të vënë në dijeni punëmarrësit përkatës ose përfaqësuesit e tyre.

Baza ligjore: Neni 6, pika 6 e Ligjit nr.10 237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar

Detyrimet e punëdhënësit në lidhje me kërkesën për sigurimin e detyrueshëm të aksidenteve në punë për punëtorët dhe punonjësit

Kur punëmarrësi nuk ka mundësi të punojë për shkak të një aksidenti në punë ose të një sëmundjeje profesionale, ai përfiton kompensimet nga sigurimet shoqërore (neni 131 i KP).

Sigurimi shoqëror i detyrueshëm është jofitimprurës dhe mbron me të ardhura personat e punësuar, ndër të tjera edhe në lidhje me aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale (neni 2 ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar).

Sigurimet shoqërore, i japin mbrojtje të detyrueshme të gjithë personave të punësuar, në rastin e pakësimit të të ardhurave, si pasojë e paafetësisë së përkohshme të shkaktuar nga sëmundja, aksidenti në punë, sëmundja profesionale dhe papunësia (neni 6 i ligjit 7703/1993 për sigurimet

shoqerore). Këshilli i Ministrave mund të vendosë për fusha të tjera mbrojtjeje, si dhe për përjashtime për: a) punëtorët sezonalë dhe të përkohshëm; b) të vetëpunësuarit në bujqësi; c) punëtorët e papaguar të familjes së personave të vetëpunësuar; ç) kursantët dhe studentët për kohën e praktikës mësimore, të cilët sigurohen vetëm për aksidentin në punë, nga punëdhënësi (neni 6 i ligjit 7703/1993 për sigurimet shoqerore).

Punëdhënësi dhe i vetëpunësuarit janë të detyruar: a) të regjistrojnë në regjistrin vjetor të gjithë të punësuarit; b) të njoftojnë në organet tatimore për ndryshimet dhe lëvizjen e punonjësve, sipas procedurave të përcaktuara me Ligj; c) të bëjnë sigurimin nga dita e parë, kur i punësuarit fillon punë; ç) të dorëzojnë në organet tatimore dokumentacionin, ku evidentohen paga dhe kontributi për çdo të punësuar, sipas formatit dhe afateve të përcaktuara me Ligj (neni 79 i Ligjit për sigurimet shoqerore).

Baza ligjore: 2 ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë.

Detyrimet e punëdhënësit për të krijuar dhe mbajtur një sistem dosjesh për regjistrimin e aksidenteve në punë në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi

Aksident në punë ose për shkak të punës është çdo ngjarje e papritur, që shkakton dëmtimin e menjëhershëm trupor, që ndodh gjatë kryerjes së punës apo të një shërbimi lidhur me të, si dhe çdo dëmtim tjetër i shëndetit, që nuk rrjedh nga sëmundje e përgjithshme, por që sjell paaftësi të përkohshme ose të përhershme në punë ose vdekje (neni 5 i Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë). Aksidentet në punë rregullohen nga Kodi i Punës, legjislacioni për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe legjislacioni për sigurimet shoqërore. dhe.

Lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë, punëdhënësi ka si detyrime të vecanta: të kryejë një vlerësim të rreziqeve për sigurinë dhe shëndetin në punë, përfshirë edhe grupet e punëmarrësve të ekspozuar ndaj rreziqeve të veçanta; të përcaktojë masat mbrojtëse që duhen marrë dhe, nëse është e nevojshme, pajisjet mbrojtëse që do të përdoren; të mbajë një regjistër të aksidenteve në punë, për rastet kur punëmarrësit përfitojnë paaftësi të përkohshme në punë për më shumë se 3 ditë pune, për shkak të aksidenteve e të sëmundjeve profesionale, si dhe të hartojë raporte për aksidentet në punë e sëmundjet profesionale, të cilat ia vë në dispozicion autoriteteve përkatëse (neni 9 i ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë). Udhëzimet për detyrimet që kanë subjektet publike dhe private për hartimin e këtyre dokumentave, miratohen nga Ministri përgjegjës për çështjet e sigurisë e të shëndetit në punë (neni 9 i ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë).

Baza ligjore: Ligji nr.10 237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar